

VENDIM
Nr.844, datë 21.10.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE LEJIMIN E KRYERJES SË PROCEDURAVE
TË PROKURIMIT PËR FONDET QË PROKUROHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”, në artikullin 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të pakësohet fondi prej 63 000 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në artikullin 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të shtohet fondi prej 63 000 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë) lekësh.

2. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përgjashtimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, si autoritet kontraktor, të vijojë kryerjen e procedurave të prokurimit, për fondet që prokurohen, të paraqitura në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kostot për ndërhyrjet në spitalet në kuadër të Grantit Japonez (fonde të cilat kërkojnë procedurë prokurimi)

Emri i institucionit	Vlera në lekë (me TVSH)
Spitali Lushnjë	3,805,000
Spitali Dibër	1,620,643
Spitali Elbasan	4,715,001
Spitali Sarandë	3,300,000
Spitali Kukës (grafia)	3,418,000
Spitali Kukës (skaneri)	2,616,356
Spitali Gjirokastrë	3,525,000
Totali	23,000,000

Në lekë (me TVSH)

Vlera e rikonstrukcioneve	23.000.000
Vlera e supervizion+kolaudim	1.000.000
Totali i fondit të kërkuar në këtë projektvendim.	24.000.000